

DIREKTIVA E KËSHILLIT, datë 10 dhjetor 1984 për ndryshimin, sidomos lidhur me asistencën turistike, e Direktivës së Parë (73/239/KEE) për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative që kanë të bëjnë me fillimin dhe ndjekjen e veprimtarisë tregtare të sigurimit të drejtpërdrejtë me përjashtim të sigurimit të jetës (84/641/KEE)

KËSHILLI I KOMUNITETEVE EUROPIANE,

Duke pasur parasysh Traktatin themelues të Komunitetit Europian, në veçanti Nenin 57, paragrafi 2, të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit [1],

Duke pasur parasysh opinionin e Parlamentit Europian [2],

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social (3),

Meqë Direktiva e Parë e Këshillit (73/239/KEE), datë 4 korrik 1973, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative të lidhura me fillimin dhe ndjekjen e veprimtarisë tregtare të sigurimit të drejtpërdrejtë me përjashtim të sigurimit të jetës (4), e quajtur më tej në këtë Direktivë "Direktiva e Parë", me shtesat dhe ndryshimet e bëra me Direktivën 76/580/KEE (5), eliminonte disa dallime të caktuara midis ligjeve të Shteteve Anëtare për të mundësuar fillimin dhe ndjekjen e veprimtarisë së lartpërmendur;

Meqë është arritur një progres i konsiderueshëm në këtë fushë të veprimtarisë tregtare të lidhur me dhënien e përfitimeve në natyrë; meqë përfitime të tilla rregullohen me dispozita që ndryshojnë nga një Shtet Anëtar në tjetrin; meqë këto dallime përbëjnë një pengesë për ushtrimin e të drejtës së vendosjes;

Meqë për ta eliminuar këtë pengesë për të drejtën e vendosjes është mirë të përcaktohet që një veprimtari të mos përjashtohet nga zbatimi i Direktivës së Parë për arsyen e thjeshtë se përbën një përfitim vetëm në natyrë ose një pagesë për të cilën personi që e jep përdor vetëm stafin ose pajisjet e veta; meqë, për rrjedhojë, një dhënie e tillë e asistencës që konsiston në premtimin e ndihmës nëse ndodh një ngjarje e rastësishme është mirë të mbulohet nga Direktiva e lartpërmendur, duke marrë në konsideratë karakteristikat e veçanta të një asistence të tillë;

Meqë qëllimi i përfshirjes, për qëllimet e mbikëqyrjes, të operacioneve të asistencës në fushëveprimin e Direktivës së Parë, që nuk prek perkufizimin e këtyre operacioneve, nuk duhet t'i prekë rregullat fiskale që zbatohen për to;

Meqë vetëm fakti i dhënies së formave të caktuara të asistencës në rast aksidenti ose avarie të lidhur me një automjet rrugor që ndodh normalisht në territorin e Shtetit Anëtar të ndërmarrjes së ofron mbulimin nuk përbën arsye për përfshirjen në objektin e rregullimeve të Direktivës së Parë të asnjë personi apo ndërmarrjeje që nuk është ndërmarrje sigurimesh;

Meqë duhen parashikuar disa lehtësime të caktuara të kushtit që aksidenti apo avaria duhet të ndodhë në territorin e Shtetit Anëtar të ndërmarrjes që ofron mbulimin në mënyrë që të merret në konsideratë ekzistenca e marrëveshjeve të ndërsjella ose disa rrethana të veçanta që kanë lidhje me situatën gjeografike apo me strukturën e organizatave në fjalë apo me rëndësinë shumë të kufizuar ekonomike të operacioneve të përmendura;

Meqë një organizatë e një Shteti Anëtar veprimtaria kryesore e së cilës është ofrimi i shërbimeve në emër të autoriteteve publike është mirë të përjashtohet nga fusha e veprimit të Direktivës së Parë;

Meqë ndërmarrja që ofron kontrata të asistencës duhet të zotërojë mjetet e nevojshme që t'i japin mundësi të ofrojë përfitime në natyrë të cilat i ofron brenda një periudhe të përshtatshme kohore; meqë është mirë të parashikohet dispozita të posaçme për llogaritjen e nivelit të aftësisë paguese dhe të shumës minimale të fondit të garancisë që duhet të zotërojë një ndërmarrje e tillë;

Meqë nevojiten dispozita të caktuara kalimtare për t'i lejuar ndërmarrjet që ofrojnë vetëm asistencë të përgatiten për zbatimin e Direktivës së Parë;

Meqë, duke pasur parasysh vështirësitë e veçanta strukturore dhe gjeografike, është e nevojshme të lejohet një periudhë kalimtare për klubin automobilistik të një Shteti Anëtar që të arrijë përmbushjen e kërkesave të Direktivës së lartpërmendur në lidhje me riatdhësimin e automjetit, mundësisht në shoqërinë e drejtuesit të automjetit dhe të udhëtarëve; (1) GZ Nr. C 51, 10.3.1981, f.5; GZ Nr. C 30, 4.2.1983, f. 6. (2) GZ Nr. C 149, 14.6.1982, f. 129. (3) GZ Nr. C 343, 31.12.1981, f. 9. (4) GZ Nr. L 228, 16.8.1973, f. 3. (5) GZ Nr. L 189, 13.7.1976, f. 13.

Meqë është e nevojshme të mbahen të përditësuara dispozitat e Direktivës së Parë në lidhje me formën ligjore që duhet të kenë ndërmarrjet e sigurimeve; meqë është mirë të ndryshohen disa dispozita të caktuara të Direktivës së lartpërmendur në lidhje me rregullat e zbatueshme për agjencitë dhe degët e vendosura brenda Komunitetit të cilat u përkasin ndërmarrjeve me zyra qendrore jashtë Komunitetit, në mënyrë që direktivat në fjalë të harmonizohen me dispozitat e Direktivës 79/267/KEE (1),

KA MIRATUAR KËTË DIREKTIVË:

Neni 1

Neni 1 i Direktivës së Parë zëvendësohet si më poshtë:

"Neni 1

1. Kjo Direktivë ka të bëjë me fillimin dhe ndjekjen e veprimtarisë së vetë-punësuar të sigurimeve të drejtpërdrejta, duke përfshirë dhënien e asistencës të përmendur në pikën 2,

të ushtruara nga ndërmarrjet e vendosura në territorin e një Shteti Anëtar ose që dëshirojnë të vendosen në të.

2. Veprimtaria e asistencës është asistencë që u jepet personave të cilët gjenden në vështirësi kur udhëtojnë, kur ndodhen larg vendbanimit ose kur ndodhen larg vendqëndrimit të tyre. Kjo veprimtari konsiston në marrjen përsipër, kundrejt pagimit paraprak të një primi, të detyrimit për të vendosur menjëherë ndihmë në dispozicion të përfituesit sipas një kontrate asistencë kur ky person ndodhet në vështirësi pasi ka ndodhur një ngjarje e rastësishme, sipas rasteve dhe kushteve të përcaktuara në kontratë.

Ndihma mund të konsistojë në dhënien e përfitimeve në të holla ose në natyrë. Dhënia e përfitimeve në natyrë mund të bëhet edhe përmes stafit dhe pajisjeve të personit që i jep këto përfitime.

Veprimtaria e asistencës nuk mbulon shërbimin, mirëmbajtjen, shërbimet pas shitjeve ose thjesht bërjen të ditur apo dhënien e ndihmës si ndërmjetësues.

3. Klasifikimi sipas klasave të veprimtarisë të përmendura në këtë nen jepet në Shtojcë.”.

Neni 2

Në nenin 2 të Direktivës së Parë shtohet pika e mëposhtme:

3. Veprimtaria e asistencës në të cilën detyrimi i kontraktuar nuk shkon përtej operacioneve të mëposhtme të ofruara në rast aksidenti ose avarie që përfshin një automjet rrugor që ndodh normalisht në territorin e Shtetit Anëtar të ndërmarrjes që ofron mbulimin: - shërbimi për avarinë i ofruar në vend për të cilin ndërmarrja që ofron mbulimin përdor, në shumicën e rasteve, punonjësin dhe pajisjet e veta,

- transportimi i automjetit në pikën më të afërt ose më të përshtatshme ku mund të bëhen riparimet dhe shoqërimi i mundshëm, normalisht përmes të njëjtave mjete të asistencës, i drejtuesit dhe udhëtarëve të mjetit në pikën më të afërt prej nga mund të vijojnë udhëtimin me mjete të tjera,

- nëse parashikohet në Shtetin Anëtar të ndërmarrjes që ofron mbulimin, transportimi i automjetit, mundësisht i shoqëruar nga drejtuesi dhe udhëtarët e automjetit, në vendbanimin, pikën e nisjes ose pikën fillestare të mbërritjes brenda atij Shteti,

nëse këto operacione nuk i kryen një ndërmarrje që është objekt i kësaj Direktive.

Në rastet e përmendura në dy nënpikat e para, kushti që aksidenti ose avaria duhet të ketë ndodhur në territorin e Shtetit Anëtar të ndërmarrjes që ofron mbulimin (a) nuk zbatohet kur kjo e fundit është një organizëm anëtar i të cilit është përfituesi dhe shërbimi i avarisë ose zhvendosja e automjetit ofrohet nga një organizëm i ngjashëm në vendin në fjalë sipas një marrëveshjeje të ndërsjellë thjesht duke paraqitur kartën e anëtarësisë, pa paguar asnjë prim tjetër shtesë;

(b) nuk e pengon ofrimin e një asistence të tillë në Irlandë dhe në Mbretërinë e Bashkuar nga një organizëm i vetëm që ushtron veprimtari në të dy këto Shtete.

Në rrethanat e përmendura në nënpikën e tretë, kur aksidenti ose avaria ka ndodhur në territorin e Irlandës ose, në rastin e Mbretërisë së Bashkuar, në territorin e Irlandës së Veriut, automjeti, mundësisht i shoqëruar nga drejtuesi dhe udhëtarët, mund të transportohet në vendbanimin e tyre, pikën e nisjes ose pikën fillestare të mbërritjes brenda njërit prej këtyre dy territoreve.

Gjithashtu, Direktiva nuk ka të bëjë me operacionet e asistencës të kryera në rast të një aksidenti ose avarie të një automjeti rrugor dhe që konsiston në transportimin e automjetit që është përfshirë në këtë aksident ose që ka pësuar avari jashtë territorit të Dukatit të Madh të Luksemburgut, mundësisht i shoqëruar drejtuesi dhe udhëtarët, në vendbanimin e tyre, kur këto operacione kryhen nga Klubi Automobilistik i Dukatit të Madh të Luksemburgut.

Ndërmarrjet që janë objekt i kësaj Direktive mund të angazhohen në veprimtarinë e përmendur në këtë pikë vetëm nëse kanë marrë autorizim për klasën 18 të shkronjës “A” të Shtojcës, pa cenuar shkronjën “C” të asaj Shtojce. Në këtë rast, për operacionet në fjalë zbatohet kjo Direktivë.”.

Neni 3

Në nenin 3 pika 1 të Direktivës së Parë shtohet paragrafi i mëposhtëm:

“Kjo Direktivë nuk zbatohet për ndërmarrjet që përmbushin kushtet e mëposhtme: - ndërmarrjet që nuk ndjekin asnjë veprimtari që bie në fushën e veprimit të kësaj Direktive me përjashtim të veprimtarisë që përshkruhet në klasën 18 të shkronjës “a” të Shtojcës,

- kjo veprimtari kryhet vetëm në mënyrë lokale dhe konsiston vetëm në përfitime në natyrë dhe

- e ardhura vjetore gjithsej e arkëtuar në lidhje me veprimtarinë e asistencës që u jepet personave që bien në vështirësi nuk është më e madhe se 200 000 EKU.”.

Neni 4

Në nenin 4 të Direktivës së Parë shtohet pika e mëposhtme:

“(f) në Danimarkë

Falcks Redningskorps A/S, København.”.

Neni 5

Në nënpikën e fundit të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 8 të Direktivës së Parë, fjalët “coöperatieve vereniging” fshihen.

Neni 6

Neni 8 pika 3 dhe neni 10 pika 3 të Direktivës së Parë zëvendësohen me paragrafin e mëposhtëm:

“Këto nuk i pengojnë Shtetet Anëtare as t'ua nënshtrojnë ndërmarrjet që kërkojnë ose kanë autorizim për klasën 18 në shkronjën "A" të Shtojcës kontrolleve për burimet e drejtpërdrejta ose të tërthorta në formë të burimeve njerëzore dhe pajisjeve, duke përfshirë edhe plotësimin e kushteve kualifikuese nga ana e ekipeve mjekësore të tyre dhe cilësinë e pajisjeve të cilat u janë vënë në dispozicion ndërmarrjeve për përmbushjen e angazhimeve që u lindin nga kjo klasë e sigurimeve.”.

Neni 7

Në nenin 9 paragrafi i parë dhe nenin 11 pika 1 paragrafi i parë i Direktivës së Parë, shkronja “e” zëvendësohet si më poshtë:

“(e) për çmuarjet në lidhje me shpenzimet e vendosjes së shërbimeve administrative dhe organizimit për sigurimin e veprimtarisë tregtare; burimet financiare me të cilat mendohet të mbulohen dhe, kur risqet që duhen mbuluar renditen në pikën 18 të shkronjës “A” të Shtojcës, burimet në dispozicion të ndërmarrjes për dhënien e asistencës së premtuar;”.

Neni 8

Neni 13 i Direktivës së Parë zëvendësohet si më poshtë:

“Neni 13

Shtetet Anëtare bashkëpunojnë nga afër me njëri tjetrin për mbikëqyrjen e pozicionit financiar të ndërmarrjeve të autorizuar. Nëse ndërmarrjet në fjalë autorizohen të mbulojnë risqet e renditura në pikën 18 të shkronjës “A” të Shtojcës, Shtetet Anëtare bashkëpunojnë edhe për mbikëqyrjen e burimeve në dispozicion të këtyre ndërmarrjeve për kryerjen e operacioneve të asistencës që kanë marrë përsipër të kryejnë, kur ligjet e tyre e parashikojnë mbikëqyrjen e burimeve të tilla.”.

Neni 9

Në nenin 16 pika 3 të Direktivës së Parë shtohet paragrafi i mëposhtëm:

“Në rastin e risqeve të renditura në pikën 18 të shkronjës “A” të Shtojcës, shumica e kërkesave për dëmshpërblim të paguara e të përdorura për të llogaritur rezultatin e dytë (baza e kërkesave për dëmshpërblim) është vlera e kostove që mbulon ndërmarrja në

lidhje me asistencën e dhënë. Këto kosto llogariten në përputhje me dispozitat kombëtare të Shtetit Anëtar në territorin e të cilit ndodhet zyra qendrore e ndërmarrjes.”.

Neni 10

Në nenin 17 të Direktivës së Parë, nënpika e dytë e shkronjës “a” të pikës 2 zëvendësohet si më poshtë:

“- 300 000 EKU në rastin kur mbulohen të gjitha ose disa prej risqeve të përfshira në njëri prej klasave të renditura në shkronjën “A” të Shtojcës në pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 16 dhe 18.”.

Neni 11

Neni 19 i Direktivës së Parë zëvendësohet si më poshtë: “Neni 19

1. Çdo Shtet Anëtar i kërkon çdo ndërmarrjeje zyra qendrore e së cilës ndodhet në territorin e saj të vendosë në dispozicion një raport vjetor të situatës financiare dhe nivelit të aftësisë paguese, ku të mbulohen të gjitha llojet e operacioneve, dhe, në lidhje me risqet e renditura në pikën 18 të shkronjës “A” të Shtojcës, edhe burimet e tjera në dispozicion të saj për përmbushjen e detyrimeve, nëse ligjet e Shtetit Anëtar e parashikojnë mbikëqyrjen e burimeve të tilla.

2. Shtetet Anëtare u kërkojnë ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në territorin e tyre të paraqesin periodikisht deklarata, së bashku me dokumente statistikore, që janë të nevojshme në funksion të mbikëqyrjes dhe, në lidhje me risqet e renditura në pikën 18 të shkronjës “A” të Shtojcës, u kërkojnë të bëjnë të ditura burimet në dispozicion të tyre për përmbushjen e detyrimeve, nëse ligjet e tyre e parashikojnë mbikëqyrjen e burimeve të tilla. Autoritetet kompetente të mbikëqyrjes i japin njëri tjetrit dokumentet dhe informacionet e nevojshme për ushtrimin e mbikëqyrjes.”.

Neni 12

Neni 26 i Direktivës së Parë zëvendësohet si më poshtë:

“Neni 26

1. Çdo ndërmarrje që ka kërkuar ose ka marrë autorizim nga më shumë se një Shtet Anëtar mund të paraqesë kërkesë për përparësitë e mëposhtme të cilat mund të jepen edhe paralelisht: (a) niveli i aftësisë paguese i përmendur në nenin 25 të llogaritet në lidhje me të gjithë veprimtarinë tregtare që ushtron brenda Komunitetit; në këtë rast, për këtë llogaritje në konsideratë merren vetëm operacionet e kryera nga të gjitha agjencitë ose degët e vendosura brenda Komunitetit;

(b) depozita që kërkon neni 23 pika 2 shkronja “e” të bëhet vetëm në njërin prej këtyre Shteteve Anëtare;

(c) aktivet që përfaqësojnë fondin e garancisë ta kenë vendndodhjen në cilindo Shtet Anëtar ku ushtron veprimtari.

2. Kërkesa për të përfituar nga përparësitë e parashikuara në pikën 1 u paraqitet autoriteteve kompetente të Shteteve Anëtare në fjalë. Kërkesa duhet të përcaktojë autoritetin e Shtetit Anëtar i cili do të mbikëqyrë në të ardhmen aftësinë paguese të të gjithë veprimtarisë tregtare të agjencive ose degëve të vendosura brenda Komunitetit. Duhet dhënë arsyet përse ndërmarrja ka zgjedhur autoritetin në fjalë. Depozita duhet të bëhet në atë Shtet Anëtar.

3. Përparësitë e parashikuara në pikën 1 mund të jepen vetëm nëse japin pëlqimin autoritetet kompetente të të gjitha Shteteve Anëtare ku është paraqitur kërkesa. Përparësitë fillojnë të zbatohen duke filluar nga koha kur autoriteti mbikëqyrës i përzgjedhur informon autoritetet e tjera mbikëqyrëse se do të mbikëqyrë gjendjen e aftësinë paguese të të gjithë veprimtarisë tregtare të agjencive ose degëve brenda Komunitetit.

Autoriteti mbikëqyrës i përzgjedhur merr nga Shtetet Anëtare të tjera informacionet e nevojshme për mbikëqyrjen e aftësisë paguese të përgjithshme të agjencive dhe degëve të vendosura në territorin e tyre.

4. Me kërkesë të një ose më shumë të Shteteve Anëtare në fjalë, përparësitë e dhëna në zbatim të këtij neni revokohen në mënyrë të njëkohshme nga të gjitha Shtetet Anëtare në fjalë.”

Neni 13

Neni 27, paragrafi i dytë, i Direktivës së Parë zëvendësohet si më poshtë:

“Sa i takon zbatimin të nenit 20, kur ndërmarrja i plotëson kushtet për përparësitë e parashikuara në nenin 26 pika 1, autoriteti përgjegjës për verifikimin e aftësisë paguese të agjencive ose degëve të vendosura brenda Komunitetit në lidhje me të gjithë veprimtarinë tregtare të tyre trajtohet në të njëjtën mënyrë me autoritetin e Shtetit ku ndodhet zyra qendrore e ndërmarrjes nga Komuniteti.”.

Neni 14

Në shkronjën “A” të Shtojcës së Direktivës së Parë, përpara fjalisë së fundit shtohet klasa e mëposhtme:

“18. Asistenca

Asistenca për personat të cilët gjenden në vështirësi kur udhëtojnë, kur ndodhen larg vendbanimit ose kur ndodhen larg vendqëndrimit të tyre.”.

Neni 15

Çdo Shtet Anëtar mund t'ua nënshtrojë, në territorin e vet, dhënien e asistencës personave që ndodhen në vështirësi në rrethana të tjera nga ato që përmenden në nenin 1, rregullimeve të miratuara me Direktivën e Parë. Nëse Shteti Anëtar e shfrytëzon këtë mundësi, këtë veprimtari e trajton, për qëllimet e zbatimit të këtyre rregullimeve, sikur të ishte renditur në klasën 18 në shkronjën "A" të Shtojcës të Direktivës së Parë, pa cenuar shkronjën "C" të saj.

Paragrafi i mësipërm nuk i prek në asnjë mënyrë mundësitë për klasifikimin e parashikuar në Shtojcën e Direktivës së Parë për veprimtaritë që dukshëm janë pjesë e klasave të tjera.

Nuk është e mundur të refuzohet autorizimi i një agjencie ose dege vetëm për shkak të arsyes se veprimtaria që mbulon ky nen klasifikohet në mënyrë të ndryshme në Shtetin Anëtar ku ndodhet zyra qendrore e ndërmarrjes.

Dispozita kalimtare

Neni 16

1. Shtetet Anëtare mund t'u lejojnë ndërmarrjeve të cilat, më datën e njoftimit të kësaj Direktive, ofrojnë vetëm asistencë në territorin e tyre, një afat prej pesë vjetësh duke filluar nga data e njoftimit të kësaj Direktive, për të zbatuar kërkesat e parashikuara në nenet 16 dhe 17 të Direktivës së Parë.

2. Shtetet Anëtare mund t'u lejojnë ndërmarrjeve të përmendura në pikën 1, të cilat pas përfundimit të afatit pesëvjeçar nuk e kanë krijuar nivelin e aftësisë paguese, një afat shtesë jo më të gjatë se dy vjet për ta bërë një gjë të tillë me kusht që këto ndërmarrje, në përputhje me nenin 20 të Direktivës së Parë, t'u kenë paraqitur për miratim autoriteteve kompetente, masat që propozojnë të marrin për këtë qëllim.

3. Çdo ndërmarrje e përmendur në pikën 1 që dëshiron ta zgjerojë veprimtarinë tregtare sipas kuptimit të nenit 8 pika 2 ose nenit 10 të Direktivës së Parë mund ta bëjë një gjë të tillë vetëm me kusht që të zbatojë Direktivën e Parë.

4. Ndërmarrja e përmendur në pikën 1, e cila ka një formë të ndryshme nga ato të renditura në nenin 8 të Direktivës së Parë, mund të vijojë, për një periudhë trevjeçare duke filluar nga njoftimi i kësaj Direktive, ta ushtrojë veprimtarinë ekzistuese tregtare në formën ligjore me të cilën ekziston më atë datë.

5. Ky nen zbatohet, me përshtatjet e duhura, për ndërmarrjet e themeluara pas datës së njoftimit të kësaj Direktive të cilat marrin drejtimin e veprimtarive tregtare të zhvilluara që përpara datës në fjalë nga organizëm juridikisht i veçantë.

Neni 17

Shtetet Anëtare mund t'u lejojnë agjencive dhe degëve të përmendura në Titullin III të Direktivës së Parë, të cilat ofrojnë vetëm asistencë në territoret e këtyre Shteteve Anëtare, një periudhë pesëvjeçare, duke filluar nga data e njoftimit të kësaj Direktive, që të zbatojnë nenin 25 të Direktivës së Parë, me kusht që këto agjenci ose degë të mos e zgjerojnë veprimtarinë tregtare të tyre sipas kuptimit të nenit 10 pika 2 të Direktivës së Parë.

Neni 18

Gjatë një periudhe tetëvjeçare prej datës së njoftimit të kësaj Direktive, kushti që aksidenti ose avaria duhet të ketë ndodhur në territorin e Shtetit Anëtar të ndërmarrjes që ofron mbulimin nuk zbatohet për operacionet e përmendura në nënpikën e tretë të paragrafit të parë të pikës 3 të nenit 2 të Direktivës së Parë kur këto operacione kryhen nga ELPA (Klubi Automobilistik i Greqisë).

Dispozita të fundit

Neni 19

1. Shtetet Anëtare bëjnë shtesat dhe ndryshimet përkatëse në dispozitat e tyre kombëtare për ta zbatuar këtë Direktivë jo më vonë se data 30 qershor 1987. Ato e informojnë për këtë Komisionin. Dispozitat e ndryshuara në këtë mënyrë zbatohen, në varësi të neneve 16, 17 dhe 18 të kësaj Direktive, maksimumi duke filluar më datë 1 janar 1988.

2. Shtetet Anëtare i komunikojnë Komisionit tekstet e dispozitave kryesore të parashikuara me akte ligjore, nënligjore ose administrative që miratojnë në fushën që rregullon kjo Direktivë.

Neni 20

Komisioni i raporton Këshillit, brenda gjashtë vjetësh pas njoftimit të kësaj Direktive, për vështirësitë që lindin nga zbatimi i kësaj Direktive dhe në veçanti nga zbatimi i nenit 15 të saj. Sipas rastit, Komisioni paraqet propozime për t'u dhënë fund këtyre vështirësive.

Neni 21

Kjo Direktivë u drejtohet Shteteve Anëtare.

Bërë në Bruksel, më 10 dhjetor 1984.

Për Këshillin